



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 269, Datë 28.12.2020**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “METODOLOGJISË SË  
LLOGARITJES SË TARIFËS PËR SHËRBIMIN E RIGAZIFIKIMIT NGA  
IMPIANTET E GNL” NË SHQIPËRI.**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 16, pika 1, germa a), të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 142/12 Prot., datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-s” në Shqipëri.

**Konstatoi se:**

- Metodologjia për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-së” është hartuar si dokument në përputhje me Ligjin 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar dhe do të zbatohet për subjektet e Sistemit të GNL-së, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE dhe që:
  - i përkasin sistemit kombëtar të gazit siç përcaktohet në nenin 4, pika 17, të Ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, dhe operojnë, mirëmbajnë e zhvillojnë një impiant GNL.
  - kanë marrë miratimin për përdorimin e impianteve ekzistuese të sistemit, në përputhje me Nenin 11 dhe Nenin 69, të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar;
  - u nënshtrohen rregullave të përgjithshme për aksesin dhe sigurimin e shërbimit të rigazifikimit nga impiantet e GNL, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar (Nenet 68 - 74).
  - impianti i GNL-së është i lidhur me Sistemin e Transmetimit
  - shkarkon dhe rigazifikon GNL-në, sipas kontratave të nënshkuara;
- Operatori i shërbimit të GNL do të zbatojë rregullat e kësaj metodologjie për qëllimin e përcaktimit të tarifave nga ERE. Përcaktimi i tarifave sipas kësaj metodologjie do të bazohet në metodën RoR.

- Operatorit të rrjetit do t'i lejohet të mbulojë kostot e justifikuara për rrjetin si dhe një kthim mbi investimin. ERE do të miratojë tarifat e rrjetit kur të plotësohen kushtet dhe parimet e kësaj metodologjie.
- Tarifat e përdorimit të rrjetit të aprovuara nga ERE do të jenë të vlefshme për një periudhë ushtrimore (1 vjeçare) për periudhën e parë rregullatore, si dhe do të jenë në përputhje me periudhën rregullatore të zbatuar për operatorët e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes.
- Shmangia nga çdo parashikim i kësaj metodologjie do të çojë në refuzimin nga ERE të aplikimit për tarifë të operatorit të GNL
- Tarifat e rrjetit do të llogariten dhe miratohen nga ERE në bazë të kostove të arsyeshme që operatori i GNL përdor për realizimin e aktivitetit dhe që janë në përputhje me këtë metodologji.
- Gjithashtu, dispozitat e Metodologjisë për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-së do zbatohen për qëllimet e përcaktimit të të ardhurave referuese dhe tarifave për shërbimin e rigazifikimit të GNL të siguruar nga depozitat e GNL të konsideruara strategjike të impianteve funksionale për procesin e rigazifikimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-s” në Shqipëri.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**